



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:268795

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352150

K.DH.SH.II.nr.1313/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses “Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica” Sh.A., me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Mentor Sejdiu nga Prishtina, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ – përkatësisht anulimi i Aktvendimit nr.03/2697/17 të datës 07.02.2018, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.69/22 të datës 21.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses “Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica” Sh.A., me seli në Mitrovicë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.69/22 të datës 21.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktgjykimin KA.nr.69/22 të datës 21.03.2023, (tani e tutje: “aktgjykimi i ankimuar”), në tërësi ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses “Kompania Rajonale e Ujësjetllësit Mitrovica” Sh.A., me seli në Mitrovicë, (tani e tutje: “paditësja”), me të cilën paditësja ka kërkuar anulimin e Aktvendimit nr.03/2697/17 të datës 07.02.2018, (tani e tutje: “akti i kontestuar administrativ”), të nxjerrë nga e paditura Agjencia Kadastrale e Kosovës (tani e tutje: “e paditura” ose “AKK”) dhe çështja të kthehet tek e paditura për rivlerësim dhe rivendosje. Dhe me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar është vendosur që secila palë ndërgjyqëse t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë paditësja për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë të aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e paditëses, ashtu që çështja të kthehet tek Gjykata e shkallës së parë për rishqyrtimin e fakteve dhe provave në mënyrë meritore, ose të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëjë regjistrimin e pronës në emër të paditëses.
3. Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar e paditura.
4. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të LPK-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:
  - Ankesa është e pabazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja brenda afatit ligjor pranë Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës për inicimin e konfliktit administrativ, me kërkesë për anulimin e aktit të kontestuar administrativ të të paditurës si të kundërligjshëm, me arsyetimin se ky akt administrativ është nxjerrë nga e paditura, si shkallë e dytë në procedurë administrative, në pikëpamje të gabuar të gjendjes faktike dhe se e paditura nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore. Paditësja në padi ka theksuar se gjendja faktike nuk është konstatuar drejtë pasi e paditura nuk e ka bërë regjistrimin e pronës në emër të paditëses, përkundër faktit se për një gjë të tillë paditësja ka ofruar prova dhe fakte tek e paditura, përmes të cilave dëshmohet vendi se ku është bërë ndërtimi i ndërtesës që paditëses iu është ndarë një banesë për kryerjen e punëve sanitare, gjë e cila është vërtetuar edhe nga institucionet gjyqësore të Republikës së Kosovës. Më tutje, paditësja në lidhje me arsyetimin e të paditurës se nuk ka mundur që të bëjë regjistrimin e pronës për arsye se për të njëjtën pronë është paraqitur edhe një palë e cila pretendon se është trashëgimtare e pronës, paditësja i ka propozuar Gjykatës së shkallës së parë që kontratën përkatëse të datës 25.02.1999 përmes së cilës është bërë bartja e së drejtës pronësore të paluajtshmërisë tek pala tjetër, të mos administrohet si provë, pasi kjo kontratë është bërë në kohën kur këto kontrata kanë qenë të njëanshme dhe të kontraktuara për përfitime materiale duke mos marrë parasysh se kujt i takon objekti apo banesa. Në këtë drejtim, paditësja ka shtuar se sipas Aktgjykimit C.nr. 6/2007 të datës 18.04.2007 të Gjykatës Komunale në Vushtrri, të vërtetuar me Aktgjykimin AC.nr.776/12 të datës 11.04.2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, është vërtetuar se paditësja është pronare dhe se e njëjta duhet të regjistrohet si pronare. Për në fund, paditësja i ka propozuar Gjykatës së shkallës së parë që t'a anulojë aktin e kontestuar administrativ të të paditurës, dhe të obligojë të paditurën që të bëjë regjistrimin e paluajtshmërisë në emër të paditëses e cila gjendet në Vushtrri, në kuadër të objektit nr. O-70202016-06003-0-51-0, ndërtesa Kalaja, Hyrja 2, banesa nr. 6, me sipërfaqe 76.24 m<sup>2</sup>, (tani e tutje: “paluajtshmëria - banesa”), si dhe ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale.
6. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë e shkallës së parë, pasi ka administruar provat e propozuara, mbajtur seancën e shqyrtimit

kryesor dhe pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar, në Aktgjykimin e saj KA.nr.69/22 të datës 21.03.2023, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

7. Gjykata e shkallës së parë pasi ka bërë vlerësimin e provave të administruara, pretendimeve të palëve dhe shkresat e lëndës në këtë konflikt administrativ, ndër të tjera, ka ardhur në konstatimet si në vijim:
  - 7.1. Me Aktvendimin nr.03/2697/17 të datës 07.02.2018, Agjencia Kadastrale e Kosovës, përkatësisht me aktin e kontestuar administrativ të të paditurës, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruar nga Mentor Sejdiu – Udhëheqës për Çështje Ligjore të paditëses, ashtu që është vërtetuar Aktvendimi nr. 18-18/2017 i datës 26.09.2017 i nxjerrë nga Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër të KK Vushtri me arsyetimin se për këtë çështje të njëjtë kontestuese kemi dy akte juridike, që ua njohin të drejtën e pronës dy personave të ndryshëm në një paluajtshmëri – banesë, prandaj për zgjidhjen e kësaj çështjeje palët duhet t’i drejtohen gjykatës kompetente, përndryshe regjistrimi i së drejtës pronësore në paluajtshmërinë – banesën përkatëse do të jetë i pamundur;
  - 7.2. Me Aktgjykimin C.nr. 6/2007 të datës 18.04.2017 të Gjykatës Komunale në Vushtri është aprovuar si pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses sa i përket lirimit të paluajtshmërisë – banesës, begatimit të pabazë dhe pjesës së shpenzimeve procedurale, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses në lidhje me lartësinë e qirasë mujore është refuzuar si e pabazuar. Ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin AC.nr. 776/12 të datës 11.04.2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, dhe po ashtu me Aktgjykimin Rev. Nr. 222/13 të datës 05.11.2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës është refuzuar revizioni i të paditurit në rastin tjetër sa i përket detyrimit për lirimin e banesës nga i padituri, ndërsa sa i përket pjesëve të tjera të aktgjykimeve të mësipërme, lidhur me begatimin e pabazë dhe shpenzimet procedurale, janë kthyer tek gjykata e shkallës së parë, përkatësisht tek Gjykata Komunale në Vushtri, për rigjykim;
  - 7.3. Nga prova Urdhëri i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nr.2S600375, është konstatuar se Komisioni ka marrë urdhër lidhur me kërkesën e z. Olivera Camilovic për paluajtshmërinë – banesën, duke vendosur që paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore varësisht nga rasti t’i jepet posedimi i pronës – objekti i kërkesës, ashtu që pala përgjegjëse dhe cilado palë tjetër që banon në këtë pronë, apo kur në lëndë nuk ka marrë pjesë banuesi, të gjithë personat që aktualisht banojnë në pronë t’u lirojnë të njëjtën brenda 30 ditësh nga dërgesa e këtij urdhëri dhe me paralajmërimin që nëse pala përgjegjëse apo ndonjë person tjetër që banon në këtë pronë, nuk i bindet urdhërit që t’u lirojë pronën brenda afatit të caktuar, të dëbohet nga prona;
  - 7.4. Me Aktvendimin nr. 18-334/2016 të datës 26.09.2017 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka refuzuar kërkesën e znj. Marija Bogosavljevic nga Mitrovica, e cila ka të bëjë me regjistrimin e paluajtshmërisë – banesës, me arsyetimin se në elaboratin kadastral objekti në fjalë nuk është pranuar teknikisht dhe ende është një pjesë e objektit të papërfunduar, si dhe njësia banesore nuk është e regjistruar në elaboratin kadastral dhe gjithashtu për të njëjtën paluajtshmëri – banesë janë dorëzuar dy akte juridike, përkatësisht Aktvendimi CT.nr. 25/2015 i datës

07.03.2016 i Gjykatës Themelore në Mitrovicë si dhe Aktgjykimi C.nr. 6/2007 i datës 18.04.2017 i Gjykatës Komunale në Vushtri i vërtetuar me Aktgjykimin AC.nr. 776/12 të datës 11.04.2013 të Gjykatës së Apelit të Kosovës;

- 7.5. Me Aktvendimin CT.nr. 25/2015 të datës 07.03.2016 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë është vërtetuar pasuria trashëgimore e të ndjerit z. Bozidar Bogosavljevic nga Mitrovica për paluajtshmërinë – banesën e cila gjendet në Vushtri, rr. ish-Vidovdan, nr. 7, kati 2, në bazë të kontratës mbi shitblerjen e banesës nr.3688 të datës 22.02.1999 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, ashtu që është shpallur si trashëgimtare për tërë tërësinë e trashëgimlënësit bashkëshortja e tij znj. Marija Bogosavljevic nga Mitrovica;
- 7.6. Për paluajtshmërinë – banesën në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, paditësja ka dorëzuar kërkesë për regjistrimin e kësaj prone e cila e plotëson kushtin nga pika a) e këtij neni, por për të njëjtën pronë ka paraqitur kërkesë edhe z. Olivera Camilovic që po ashtu ka plotësuar kushtin ligjor si më lartë;
- 7.7. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vlerësuar se rezulton se e paditura ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën administrative të paditëses me të cilën paditësja ka kërkuar regjistrimin e paluajtshmërisë – banesës në emër të saj, pasi për të njëjtën paluajtshmëri – banesë ekzistojnë dy akte juridike, përkatësisht dy baza të ndryshme juridike, të cilat i'a njohin pronësinë dy personave të ndryshëm. Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura drejtë ka udhëzuar paditësen që lidhur me vërtetimin e pronësisë t'i drejtohet gjykatës kompetente për të zgjidhur çështjen kontestuese mes tyre, pasi në procedurë administrative janë paraqitur dy akte të ndryshme juridike (Vendimi HPCC/D/88/2003/C i datës 29.08.2003 të nxjerrë nga Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës dhe Aktgjykimi C.nr. 6/2007 i datës 18.04.2007 i Gjykatës Komunale në Vushtri) që ua njohin të drejtën pronësore dy personave të ndryshëm në paluajtshmërinë – banesën e njëjtë; dhe
- 7.8. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka shqyrtuar edhe pretendimin e paditëses në lidhje me kalimin e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri – banesë tek personi tjetër sipas kontratës nr. 3688/2 të përpiluar me datë 25.02.1999 në kohën kur këto kontrata kanë qenë të njëanshme, mirëpo Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se një pretendim i tillë për anulimin e një kontrate për kalimin e pronësisë nuk mund të shqyrtohet në një procedurë të konfliktit administrativ dhe se një gjë e tillë as nuk ka mundur të shqyrtohet në procedurë administrative pranë organit administrativ, ashtu që vlerësimin e ligjshmërisë së kësaj kontrate paditësja mund t'a kërkojë në procedurë kontestimore.
8. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi: aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së; dhe se në aktgjykimin e ankimuar është bërë konstatimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike.

9. Kolegji i kësaj gjykate, sa i përket pretendimeve ankimore të paditëses në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gjeti se në ankesë nuk ekziston ndonjë pretendim ankimor që mbështetet në argumente bindëse, ndryshe nga ato që janë në padi dhe në shkresat e lëndës për të cilat Gjykata e shkallës së parë veçse ka dhënë vendim. Gjithsesi, Kolegji i kësaj gjykate nga shqyrtimi i bërë në ankesë, aktgjykimin e ankimuar, dhe shkresat e tjera të lëndës gjeti se Gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Po ashtu, Gjykata ankimore gjeti se ndërmjet shkresave të lëndës dhe gjendjes së konstatuar faktike me aktgjykimin e ankimuar nuk ekziston ndonjë mospërputhje. Si rrjedhojë, Gjykata ankimore pretendimet ankimore të të paditurit në lidhje me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike i vlerësoi si pretendime të pabazuara.
10. Gjykata ankimore vlerësoi se ekzistimi i disa pretendimeve për të drejtën pronësore të disa subjekteve të së drejtës mbi të njëjtën pronë, sikurse në rastin konkret, kualifikohet si kontest pronësor, përkatësisht si kontest juridiko-civil, dhe si i tillë ky kontest i natyrës civile mund të shqyrtohet dhe zgjidhet nga gjykatat civile në procedurë kontestimore, dhe jo nga ana e gjykatave administrative në konflikte administrative, e aq më pak nga ana e organve publike në procedura administrative. Si rrjedhojë e kësaj, pretendimet e ndryshme të subjekteve në rastin konkret për të drejtat e tyre pronësore në paluajtshmërinë – banesën e pretenduar nuk mund të fitohen si e drejtë pronësore përmes konfliktit administrativ, me c'rast organi administrativ me të drejtë e ka refuzuar kërkesën e paditësit.
11. Gjykata e shkallës së dytë konstatoi se Gjykata e shkallës së parë me plotë të drejtë ka vlerësuar aktin e kontestuar të të paditurës si të ligjshëm, përkatësisht vlerësimin e të paditurës si organ i shkallës së dytë në procedurë administrative si vlerësim i drejtë dhe i saktë, sepse e paditura në këtë rast Agjencia Kadastrale e Kosovës në bazë të legjislacionit në fuqi e ka pasur të pamundur të veprojë ndryshe. Në këtë drejtim:
- 11.1. Së pari, Ligji nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, duke përfshirë edhe ligjet përkatëse që bëjnë ndryshimin dhe plotësimin e tij, si dhe Ligji Nr. 04/-L-013 për Kadastër (të aplikueshëm në kohën e nxjerrjes së aktit të kontestuar administrativ) nuk i ofrojnë kompetencë lëndore AKK-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të aplikuesve për regjistrimin e të drejtave pronësore të dy apo më shumë subjekteve të ndryshme për të njëjtën paluajtshmëri, përkatësisht për zgjidhjen e kontesteve pronësore që ekzistojnë ndërmjet aplikuesve pranë saj. Për më shumë, AKK bënë vetëm regjistrimin e të drejtave pronësore mbi paluajtshmëritë duke u bazuar në akte juridike të besueshme, dhe AKK nuk mirret doemos me shqyrtimin se kush është pronari real i paluajtshmërisë. Prandaj, duke pasur parasysh mungesën e një kompetence të tillë lëndore, e paditura, në këtë rast Agjencia Kadastrale e Kosovës me plotë të drejtë nuk i ka tejkualuar kompetencat e veta ligjore;
- 11.2. Së dyti, Ligji nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme qëndron i heshtur në lidhje me atë se a dallojnë apo jo për nga pesha juridike aktet juridike që baraqesin baza juridike për regjistrimin e të drejtave pronësore mbi paluajtshmëritë të renditura me nenin 4 të këtij ligji. Prandaj, duke qenë

se ekziston një heshtje e tillë ligjore, duhet nënkuptuar që këto akte juridike të renditura me nenin 4 të këtij ligji për nga pesha juridike janë të njëjta. Si rrjedhojë, pretendimet e paditësit për regjistrimin e të drejtës pronësore nuk mund të merren të bazuara për faktin se para organit administrativ ekzistojnë kërkesa për të njëjtin objekt pronësor nga disa palë aplikuese. Duhet nënvizuar fatkin se paditësi pretendon vërtetimin e pronësisë mbi bazën e një aktgjykimi i cili vetëm konstaton lirimin e pronësisë, pra përmes një aktgjykimi kontumacional, me të cilin nuk mund të vërtetohet e drejta e pronësisë.

- 11.2.1. Neni 4 i Ligjit nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme thekson: “... *Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistruhen në bazë të: a). vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës; b). vendimit të organit administrativ shtetëror; c). kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent; d). vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; e). vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit; f). vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe g). dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore*”;
- 11.2.2. Në kuptim të dispozitës së lartë cituar ligjore, Aktgjykimi C.nr. 6/2007 i datës 18.04.2007 i Gjykatës Komunale në Vushtrri të cilin aktgjykim paditësja e konsideron si bazë juridike për regjistrimin e së drejtës së saj pronësore mbi paluajtshmërinë – banesën, kualifikohet si bazë juridike e pranueshme në bazë të pikës a) të kësaj dispozite ligjore, ndërsa Vendimi HPCC/D/88/2003/C i datës 29.08.2003 të nxjerrë nga Agjencia Kosovare për Krahësimin dhe Verifikimin e Pronës të cilin vendim znj. Olivera Camilovic e konsideron si bazë juridike për regjistrimin e së drejtës së saj pronësore mbi paluajtshmërinë – banesën e njëjtë, kualifikohet si bazë juridike e pranueshme në bazë të pikës b) të kësaj dispozite ligjore. Prandaj, duke pasur parasysh se e paditura është ballafaquar me një situatë ku dy aplikues kanë aplikuar me dy baza juridike të ndryshme dhe të pranueshme për regjistrimin e të drejtave të tyre pronësore mbi të njëjtën paluajtshmëri – banesë, me plotë të drejtë ka vendosur sikurse në aktin e kontestuar administrativ.
12. Për më tepër, Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se mosshqyrtimi i ligjshmërisë së kontratës nr. 3688/2 të përpiluar me datë 25.02.1999 nga ana e Gjykatës së shkallës së parë ka qenë një veprim i drejtë dhe i saktë sepse sikurse edhe kontesti pronësor po ashtu edhe ligjshmëria e një kontrate paraqet çështje që i takojnë kompetencës lëndore të gjykatave civile, dhe të cilat duhet të shqyrtohen e zgjidhen në procedura kontestimore, dhe jo në procedurë të konfliktit administrativ nga një gjykatë administrative, sikurse shqyrtimi i ligjshmërisë së po të njëjtës kontratë nuk ka mundur të jetë objekt shqyrtimi i procedurës administrative të zhvilluar pranë të paditurës.
13. Si përfundim, Gjykata ankimore gjeti se e paditura duke refuzuar kërkesën e paditëses për regjistrimin e së drejtës së saj pronësore mbi paluajtshmërinë – banesën në fjalë, ajo nuk ka kontestuar assesi mundësinë e ekzistimit të drejtës pronësore të paditëses mbi këtë paluajtshmëri – banesë, sikurse edhe nuk ka kontestuar të drejtën e pronësisë së dy aplikueseve të tjera,. Mirëpo, e paditura për nga aspekti procedural e ka pasur të pamundur regjistrimin e një të drejte

të tillë ku sikurse paditësja pranë saj kanë aplikuar edhe dy subjekte të tjera me pretendime po të njëjta. Duke marrë parasysh se e paditura në bazë të kompetencave të saja ligjore ka për detyrim vetëm regjistrimin e të drejtave pronësore mbi paluajtshmëritë, të paditurës nuk i ka takuar assesi shqyrtimi se kujt me të vërtetë i takon e drejta e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri – banesë. Prandaj, gjykimi i Gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kontestuar administrativ të të paditurës, paraqet një gjykim të drejtë dhe të saktë.

14. Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje të konfliktit administrativ, prandaj në mbështetje të nenit 209, para. 1, pika (b) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1313/23 datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari  
Dren Rogova